8	Zjarrfikse	3					3
9	Volzvagen Amarok 4+1		1				1
10	pompe thithese uji		3	1	1	1	6
11	Ambulance						1
12	Laborator						2
13	gjenerator 5,5 kw		1				1
14	spitale, hotele						0
15	Ambjente per evak.						0
16	Çadra, tenda					0	0
17	Autobot	1					1
18	Kamjonqine iveko 3t AA036PN		1	2	1		4
19	Kamjonqineiveko 0.5tAA269JO		1	1	1		3
20	Kamjonqine iveko 3t 65C14D			2	1	1	4
21	Autovinçpiagio poater maxxi					1	1
22	Ford Ranger XL 2t			1		1	2
23	Dumdum 0,8t AB579HG				1		1
24	Gjenerator 3,4kw benzine	1		1			2
25	Gjenerator 7kw					1	1
26	Pomp Protabel	1					1
27	Motorr sharre chain	1					1
28	Subjekte(hotele)privat						12 (141dhom)
29	Subjekte(Laborator)privat						13



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ

Nr	Emertimi	Arsimi Nr	Shendetisa	Policia Nr	Elektriku Nr		Totali 2
	Personel	1026	160	140	81		1407

TOTALI 3186

BURIMET LOGJISTIKE

DATABASE TË MJETEVE TË KATËR NDERMARRJEVE VARTËSE

Nr	Tipi i mjetit, pesha, te dhenat tjera	Targa	Drejtuesi i mjetit	Nr. tel
A	Nd. Sherb, Publike			
1	Minieskavator (Hap gropa, kanale)	Nuk ka	Ilir Alla	682799767
2	Gjenerator	Nuk ka		
3	Prerese Asfalti	Nuk ka		
4	Batipal (Shtypëse asfalti, rëre)	Nuk ka		
5	Kamionçinë	AB368HL	Artur Algjoni	682534610
6	Autovinç	AA982OG	Flamur Lame	
7	Ford Range	AB811IV	Lekë Pjetëgjoka	682814823
8	MG	AB959OC		
B	Nd. Gjelberimit			
1	IVEKO	AA036PN	Shkelzen Gjabri	0675137785
2	IVEKO	AB238LV	Kudusi Rexhmataj	0682423899
3	Gjenerator 3.4 kw 3 Fazor me benzene		Tauland Cevani	0685218070
4	Pompe thithse		Xhemal Kola	0682155892
C	Nd. Pastrimit			
1	Renault Access	AB 728 OY	Artur Marku	0683014121
2	Renault Access	AB 446 OY	Fatjon Vladi	0692108906
3	IVECO / AD 260T	AB 467 PT	Xhevahir Demiri	0685672759
4	IVECO / IG149E2CA	AB 579 PV	Skënder Përgjegja	0683654515
5	RENAULT / 44AHL8 MIDLUM	AB 466 PT	Kastriot Alija	0685866705
6	Dumdum	AB 579 HG	Artan Koleci	0682295973
7	Renault	AB 617 PT	Fatmir Beba	0682249470
Ç	Nd. UKK			
1	Mt Volvo B161b,2015,Fadrome	ADMT02	Naim Hamzaj	682270000
2	Volkswagen Amarok,2015 Fuoristrade	AA568MZ	Lulezim Gjuni	693333533
3	Iveco Fiat Daily,2010,A,Kamionçine	AB180NA	Fatos Zelia	685194532
4	Ford 2008,Kamionçine		Elson Koldashi	683623420



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ

Mjete Sherbimi Bashkia

Nr	Tipi i mjetit, pesha, te dhenat tjera	Targa	Drejtuesi i mjetit	Nr. telefonit
1	Benx ML	AB937AY	Mifta Haxhiu	0683522610
2	Furg/Ford	AA936LH	Agron Elezaj	0686690966
3	Furg/Ford	AB178FN	Bujar Kaptina	0694132301
4	Hyndai	AA883YL	Gjergj Kacani	0685666245
5	Hyndai	AB899JP	Migesa Lami	0686931176
6	Hyndai	AB875JP	Baftjar Ndreu	0682380603
7	Autovetur	AB663RM	Kastirot Koldashi	0685218174
8	Aut opel	AB670RM	Nesim Gjuta	0692197267
9	Aut opel	AB668RM	Petrit Marku	0694458740
10	Zjarr Fikse 3 copë	tel. 128	Grupet e punës	Dr. MZSH
11	Autobot Uji	tel. 128	Grupet e punës	0672819600
12	Autoshkallë	tel. 128	Grupet e punës	0672819600

STRUKTURA BAZË NË BASHKI

Në bashki, shërbimi i emergjencave civile në nivel vendor funksionon përmes tre strukturave bazë të cilat janë:

Strukturat monitoruese dhe njoftuese në bashki

- Prefekti i Qarkut Tirane.
- Komisariati nr: 5 i Policisë.
- Njësiti Vendore të Kujdesit Shëndetësor.
- Strukturat me detyra monitoruese dhe njoftuese të bashkisë.

Këto struktura kanë për detyrë të japin të dhëna të vazhdueshme pranë Prefektit të Qarkut dhe bashkisë për parashikimin e fatkeqësive dhe përballimin e tyre në të gjithë territorin e bashkisë.

Të tjerë faktorë që japin kontribut në njoftimin për emergjencat janë qytetarët, kryetarët e fshatrave, OJF-të e ndryshme, subjektet private.

Strukturat Vepruese Aktive në bashki

- Sektori i MZSH -së bashki
- Komisariati i Policisë (nr.5) në bashkinë Kamez
- Shërbimet e ambulancës, të urgjencës së Njesisë Vendore të Kujdesit Shëndetësor
- Policia Bashkiake



REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA KAMËZ

Këto struktura angazhohen menjëherë në situatat e emergjencave civile dhe vihen në dispozicion të bashkisë dhe të Prefektit të qarkut.

Strukturat Vepruese Mbështetëse në bashki

- Kryqi i Kuq Shqiptar dega kamez.
- Caritas
- World Vision
- OJF të tjera që veprojnë në bashki.

Strukturat vepruese mbështetëse në bashki janë planifikuar për ndërhyrje në situata emergjente në mbështetje të strukturave vepruese aktive. Menaxhimi efektiv i emergjencave në bashki kërkon bashkëpunim midis aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm në të gjitha fazat e procesit. Kështu, programet e menaxhimit të emergjencave kërkojnë të zhvillojnë lidhje të ngushta me aktorët që mund të thirren për mbështetje.

Mbrojtja civile është një seksion i përgjithshëm për të katër fazat e menaxhimit të emergjencave civile, konkretisht: parandalimi/lehtësimi, gatishmëria, përgjigjja dhe rimëkëmbja.

Në të janë përshkruar parimet udhëzuese teknike të menaxhimit të emergjencave civile që janë tetë: Parashikimi, informacioni, gatishmëria, integrimi, vendimmarrja, bashkëpunimi, udhëheqja dhe vazhdimësia.

Parandalimi përfshin aktivitetet dhe masat për shmangien e plotë të risqeve të fatkeqësive ekzistuese dhe atyre të reja.

Lehtësimi është zvogëlimi ose kufizimi i ndikimeve negative të rreziqeve e fatkeqësive të lidhura me to.

Objekti kryesor i fazës së gatishmërisë është të evitohet humbjet e jetës dhe të pasurive. Elementet kyçe të gatishmërisë janë ngritja dhe fuqizimi i kapaciteteve të sistemit të mbrojtjes civile dhe komuniteteve për të parashikuar, për të përballuar dhe për t'u rimëkëmbur.

Përgjigjia ndaj Emergjences

Përgjigje" është ofrimi i shërbimeve emergjente dhe të asistencës para dhe gjatë një fatkeqësie ose menjëherë pas saj, për mbrojtjen e jetës së njerëzve, të gjësë së gjallë, të pronës, të trashëgimisë kulturore dhe të mjedisit, për të garantuar sigurinë publike dhe për të përmbushur nevojat themelore për mbijetesë të njerëzve të prekur.

Ne një situatë emergjente duhet të përpiqeni të plotësoni tetë qëllime:

1. Siguro shëndetin.
2. Shpëto jetë.
3. Zvoglo vuajtjet.
4. Mbro shëndetin public.
5. Mbro pronën.
6. Mbro infrastrukturën.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ

7. Mbro mjedisin.
8. Zvoglo humbjet ekonomike dhe sociale.

Faza e përgjigjes kalon në këto etapa:

- **Etapa 1:** “Alarmi për rritjen e gatishmërisë” është tërësia e masave për njoftimin paraprak pas marrjes së informacionit se mund të lindë një situatë emergjence dhe shërben si sinjal për rritjen e gatishmërisë;
- **Etapa 2:** “Gatishmëria” është tërësia e masave për njoftimin paraprak, pasues, pas informacionit që një situatë emergjence është e afërt ose në zhvillim;
- **Etapa 3:** “Aktivizimi” - kur situata emergjente ka ndodhur realisht;
- **Etapa 4:** “Dalja nga situata” - përmbyll fazën e përgjigjes, pavarësisht nga sa faza të mëparshme kanë ndodhur realisht.

Alarmi

- Informon Kryetarin e Bashkisë dhe Prefektin, për aktivizimin e etapës “Alarm për rritjen e gatishmërisë”.
- Informon drejtuesit e Njësive Administrative të bashkisë.
- Në koordinim me Institucionin e Prefektit informon strukturat e MZSH, FA, etj dhe kërkon prej tyre vënien në gatishmëri të strukturave dhe dhënien e informacionit të vazhdueshëm për situatën.
- Verifikon gatishmërinë për punë 24 orë të Drejtorisë së Emergjencave Civile dhe QOE në bashki.
- Në koordinim me Institucionin e Prefektit komunikon me strukturat monitoruese dhe njoftuese në juridiksionin e bashkisë dhe kërkon prej tyre vrojtimin, dhënien e informacionit të vazhdueshëm dhe parashikimin për zhvillimin situates.
- Në koordinim me Institucionin e Prefektit informon të gjitha institucionet dhe strukturat vepruese aktive, vepruese mbështetëse në territorin e bashkisë dhe kërkon prej tyre konfirmimin e situatës, gjendjen dhe vendndodhjen.
- Kontrollon mjetet e komunikimit, përditësimin e listave e kontaktit të planit të emergjencave civile dhe aktivizon sistemin e paralajmërimit me të gjithë anëtarët e KMC në bashki.
- Verifikon nëse kapacitetet e deklaruara në planin e emergjencave civile të strukturave të bashkisë janë në gatishmëri, të pajisura me mjetet e nevojshme dhe nëse kanë rezervë të mjaftueshme karburanti.
- Kërkon informacion për rezervën cash që disponon çdo strukturë varësie e bashkisë dhe Nj.A për situatat emergjente.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ

- Siguron informacion të saktë për të bërë paralajmërimet dhe këshillimet e duhura për publikun me anë të mjeteve të informimit.
- Përgatit informacion të përmbledhur për Institucionin e Prefektit sikurse dhe AKMC-në (nëse është e nevojshme).

Gatishmeria

Informojnë Kryetarin e Bashkisë dhe Prefektin, për aktivizimin e etapës 2 “Vendosja e Gjendjes së Gatishmërisë”.

Pas miratimit të Titullarit aktivizohet QOE në bashki.

Pas miratimit të Titullarit mbledhet KMC dhe kërkohet përgatitja për procesin e marrjes së vendimeve takimeve informative për median dhe partnerët.

Informon drejtuesit e Nj.A të bashkisë.

Në koordinim me Institucionin e Prefektit, informon strukturat e MZSH, FA, etj dhe kërkon prej tyre ndjekjen e situatës sipas planit të emergjencave dhe dhënien e informacionit të vazhdueshëm për situatën.

Në koordinim me Institucionin e Prefektit komunikon me strukturat monitoruese dhe njoftuese në juridiksionin e bashkisë dhe kërkon prej tyre vrojtimin, dhënien e informacionit të vazhdueshëm dhe parashikimin për zhvillimin situates.

Në koordinim me Institucionin e Prefektit informon të gjitha institucionet dhe strukturat vepruese aktive, vepruese mbështetëse në territorin e bashkisë dhe kërkon prej tyre konfirmimin e situatës, gjendjen dhe vendndodhjen.

Harton raportin e parë për situatën dhe informacione periodike të cilat sipas rastit i dërgohen Prefektit dhe AKMC-së.

Përgatit informacione për Institucionin e Prefektit, AKMC-në, publikun, median, donatorët, KKSH, dhe OJF- të e interesuara.

Përgatit materiale paraprake mbi dëmet, nevojat e pritshme për zonën, natyrën e fatkeqësisë, vlerësimin e risqeve etj.

Në bashkëpunim me Institucionin e Prefektit, krijojnë/merr pjesë në grupe të përbashkëta vlerësimi dhe verifikimin e të dhënave për situatën për zonat e rrezikuara nga fatkeqësia.

Kontrollon dhe siguron që të gjitha masat e mëparshme a janë përmbushur. QOE në bashki punon me staf të plotë të pajisur për të punuar në etapë gatishmërie për 24 orë.

Informon popullatën për skenarin e pritshëm dhe / ose në vazhdim dhe komunikon me popullatën, përfshirë vullnetarët, për nevojën e zbatimit të masave të vetëmbrojtjes. U siguron me urgjencë qytetarëve informacion të mjaftueshëm për shkallën e ekspozimit ndaj riskut me mjetet që konsiderohen më të përshtatshme. Në informimin e popullatës, ajo u jep përparësi banorëve të zonave me risk.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA KAMËZ

Siguron parandalimin, mbrojtjen, shpëtimin dhe ndihmën për popullatën në zonën me risk
Në rastet e riskut të përmbytjes, urdhëron që të ndërpriten të gjitha aktivitetet në
shtretërit e lumenjve (Tiranë dhe Lana) dhe sigurinë e automjeteve dhe makinerive në përputhje
me masat e sigurisë për operatorët.

Në rastet e riskut të përmbytjes monitoron nivelin e ujit dhe gjendjen e punimeve
mbrojtëse të argjinaturave përgjatë rrugëve ujore kryesore në bashki.

Garanton që vëzhgimet e kodifikuara, instrumentale ose jo, që vijnë nga autoritetet, të
vihen në dispozicion të strukturave të bashkisë.

Verifikon disponueshmërinë / funksionalitetin e zonave të emergjencës, lehtësirat e
pritjes së popullatës dhe rrugët e evakuimit.

Në rastet e riskut të përmbytjes, kryen kontrole territoriale hidrogeologjike përmes zbulimit
dhe inspektimit të paktën të zonave të ekspozuara ndaj riskut të lartë dhe shumë të lartë,
gjithashtu me monitorimin “me sy” të rrëshqitjeve të mundshme dhe/ose të dukshme;
monitoron pikat kritike, përfshirë me mbështetjen e forcave vullnetare..

Aktivizimi

1. Sigurohet për aktivizimin e strukturave dhe kapaciteteve të përgjigjes në nivel bashkie si dhe
vënien në funksion të KMC.B dhe funksionimin e plotë të QOE në bashki.

2 Nëse nuk është bërë ende mbledhja e KMC.B, mbledh urgjentisht atë pjesë të domosdoshme të
tij për konsultime sipas llojit të emergjencës për procesin e marrjes së vendimeve .

3 Së bashku me Institucionin e Prefektit siguron që gjitha strukturat monitoruese dhe njoftuese si
edhe strukturat vepruese aktive dhe vepruese mbështetëse të jenë funksionale dhe në veprim për
situatën.

4 Nëse është e nevojshme i propozon Kryetarit të bashkisë që t'i kërkojë Prefektit deklarin e
“Gjendjes së fatkeqësisë natyrore” për zonën e prekur.

5 Nëse nuk është bërë ende, në bashkëpunim me Institucionin e Prefektit, krijon/merr pjesë në
grupe të përbashkëta vlerësimi dhe verifikimin e të dhënave për situatën për zonat e rrezikuara
nga fatkeqësia.

6 Kërkon informacion periodik rreth situatës në terren nga grupet e përbashkëta të vlerësimit për
situatën.

7 Harton raportin e parë për situatën dhe informacione periodike, të cilat sipas rastit i dërgohen
Prefektit dhe AKMC-së.

8 Përgatit informacione për Institucionin e Prefektit, AKMC-në, publikun, median, donatorët,



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ**

KKSH, dhe OJF- të e interesuara.

Për fatkeqësi të shkallës së lartë:

9 Verifikon që hapat e sipërshënuar: 1, 2, 3, 4, 6 dhe 8 janë përmbushur dhe në zbatim të pikës 1, KMC.B dhe QOE në bashki janë në funksion të plotë.

10 Harton raporte të situatës me shkrim për Prefektin, ose direkt për QKOEK.

11 Bashkërendon strukturat vendore në nivel lokal, si dhe strukturat e tjera qendrore ose ndërkombëtare që vijnë në ndihmë Sipas planit operacional dhe urdhrave të përditshëm të KMC në Qark

12 Mban lidhje të rregullta dhe kontakte të vazhdueshme me drejtuesit e tjerë të FO në nivel qarku dhe të bashkive fqinje, informon dhe kërkon asistencë nga DOQ në qark dhe DQO

13 Zbaton detyrat dhe urdhrat e marra nga KMC në bashki dhe Prefektin e qarkut si edhe nga DQO.

Nëvoja për Bashkëpunim

Operacionet që ndërmerren në përgjigjen ndaj emergjencave në shkallë të gjerë janë të ndryshme nga ato operacione që ndërmerren në përgjigje të incidenteve të përditshme ose të fatkeqësive të zakonshme në shkallë të vogël.

Në varësi të përmasave të fatkeqësive, përcaktohen më përpara nevojat e operacioneve për përballim, në të cilat u kërkohej institucioneve dhe strukturave të kryejnë detyra nën presion kohor dhe të ndryshme nga ato që ata kryejnë në punën e tyre të përditshme.

Shpesh lindin nevoja që tejkalojnë kapacitetet e institucioneve dhe strukturave të veçanta duke u kërkuar kështu që të bashkërendohen dhe ndahen detyrat me institucione dhe struktura, të cilat përdorin procedura të panjohura për ta.

Këto kërkesa të veçanta si dhe sfidat e krijuara si pasojë e fatkeqësisë, me të cilat përballen shumë organizata, nxjerrin në pah nevojën për procedura dhe struktura qeveritare të emergjencave, të cilat kanë si qëllim bashkërendimin dhe menaxhimin efektiv të operacioneve të gjithanshme për përballimin e fatkeqësisë. Bashkërendimi ndërmjet strukturave dhe organizatave nxitet nga mekanizma të ndryshëm.

Qendra Operacionale e Emergjences

Një element kritik për menaxhimin e emergjencave është bashkërendimi. Sapo përballemi me fatkeqësinë, ngritja e QOE-së në bashkinë e prekur nga fatkeqësia është mjaft e rëndësishme për të pasur një bashkërendim të suksesshëm.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA KAMËZ

QOE-ja është një strukturë bashkërendimi dhe komunikimi midis drejtuesve kryesorë dhe organizatave të përfshira në përgjigjen ndaj emergjencës, e cila lehtëson shkëmbimin e informacionit midis tyre. Ajo shërben edhe si një sekretari teknike që ndihmon punën për funksionimin e KMC-së dhe Drejtuesit të Operacioneve në nivel bashkie, në varësi të përmasave të emergjencave.

Funksionet kryesore të QOE-së janë:

- Bashkërendimi i punës së strukturave, të agjencive dhe të organizatave të ndryshme.
- Bashkërendimi i centralizuar i operacioneve për përballimin e emergjencës, në mbështetje të KMC në bashki dhe Drejtuesit të Operacionit në bashki.
- Mbledhja dhe ndarja e informacionit dhe raportimi zyrtar.
- Dhënia e informacionit publikut dhe medias.

Përgjegjësitë e QOE së

- Ushtron efektivisht autoritetin, kur paraqitet nevoja.
- Lehtëson komunikimin në kohë dhe ndarjen e informacionit.
- Mobilizon efektivisht personelin dhe burimet.
- Komunikon në kohë me publikun.
- Ofron zgjidhje të shpejtë të mosmarrëveshjeve midis aktorëve në lidhje me qëllimet, taktikat dhe burimet.

- Lehtëson ndërveprimin efektiv ndërmjet autoriteteve të qeverisë qendrore, Prefektit të qarkut, bashkisë dhe aktorëve të tjerë.

Kur situata e lejon, Kryetari i Bashkisë në konsultim me Sekretarin e Përgjithshëm ose/dhe Nënkryetarin dhe sipas nevojës edhe me sektorin e EC, aktivizon QOE-në dhe cakton një koordinator të veprimeve të QOE-së dhe personel me përgjegjësi të përditshme për menaxhimin e kësaj qendre. Elementët mbështetës të QOE-së do të aktivizohen në rast se këtë e kërkon situata e emergjencës. QOE-ja aktivizohet menjëherë në të gjitha rastet e shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore në një territor që përfshin të paktën një Njësi Administrative të bashkisë.

Në shkaqet për aktivizimin e QOE përfshihen:

- Është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore.
- Numër i konsiderueshëm i personave në risk.
- Shkalla e kërcënimit për njerëzit, pronën, trashëgiminë kulturore ose mjedisin.
- Kërkohet mbështetje në vend (aktivizimi afatgjatë, burimet e kufizuara, etj.).
- Koordinimi i burimeve që kërkohet për shkak të burimeve të kufizuara lokale dhe/ose madhësisë dhe shtrirjes së emergjencës/fatkeqësisë.
- Shqetësim i lartë i ngritur nga media ose publiku/palët e interesit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA KAMËZ

Personeli dhe Objektivat

Personeli i QOE-së do të përbëhet nga:

- Drejtuesi/koordinatori i veprimeve (del nevoja për dy persona, nëse puna do të vazhdojë 24 orë në ditë).
- specialistë përfaqësues të zyrave dhe të strukturave të cilat kanë lidhje me emergjencat dhe të organizatave të cilat i ofrojnë ndihmë personelit të operacioneve.
- personel mbështetës administrative.
- të tjerë.

Objektivat bazë që duhet të arrihen në këto takime nga QOE-ja:

- Qartësimi dhe delegimi i përgjegjësisë për aktivitete të ndryshme të përballimit të emergjencave.
- Inventarizimi dhe evidentimi i asistencës së ardhur për përballimin e fatkeqësisë.
- Shpërndarja dhe verifikimi i vlerësimit të nevojave dhe informacionit për përballimin e fatkeqësisë.
- Identifikimi i informacionit që duhet t'i shpërndahet publikut. QOE-ja, gjithashtu, përzgjedh personin që do të shërbejë si zëdhënës zyrtar për marrëdhëniet me median.
- Bashkërendimi i transportit dhe shpërndarja e ndihmës së ardhur për përballimin e emergjencës

Menaxhimi i Emergjencës. Modeli i Ndërhyrjes

Informacioni i lidhur me menaxhimin e emergjencës duhet të ndjekë linjën e autoritetit në skemën organizative të menaxhimit të emergjencave civile në nivele të ndryshme. Kjo bazohet në përmbajtjen e ligjit 45/2019, veçanërisht në nenin 7 (parimi i subsidiaritetit) dhe nenin 40 të tij.

Rreziqet dhe rrisqet

Zonat me risk në territorin e Bashkisë sona janë:

- Zona Valias (Rr. Nato tek Lokal Vllezrit Lleshi).
- Zona Frutikulturë (rr. Donald Tramp.... Tek local Kolis).
- Zona Paskuqan (Bregu I Lumit Tiranës).
- Zona Paskuqan (Poshtë diges liqenit)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ

Grafiku i rriskut të fatkeqësive

Nr	Emërtimi	Shqipëria %	Tirana %	Kamza %
1	Termeti	2.33	5	5
2	Rreshqitje	2.42	3	1
3	Orteke	1.75	1	0
4	Zjarret masive	2.17	3	4
5	Permbytjet	3.67	3	4
6	Çarjet e digave	3.75	3	3
7	Teknologjike	3.67	5	5
8	Biologjike	3.17	5	6
9	Shume rreziqe		3.63	3.63


Nga vëzhgimi i tabelës dhe grafikut duket se rreziqet e fatkeqësive për Bashkinë Kamëz janë të përafërta me ata të Bashkisë Tiranë. Rreziku i orteqeve nuk ekziston, dhe rreziku nga rrëshqitjet e tokës janë më të vogla.

Risqet më kritike nga fatkeqësitë, me ndikim negativ në zhvillimin e zonës, janë **rreziqet teknologjike dhe biologjike, të pasuara nga tërmetet. Në vëmendjen tonë duhet marrë në konsideratë edhe risku i përmbytjeve.**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ

Chart Title





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ

Harta Paskuqan





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ

Hartë. Lagjja Bathore





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ

Hartë. Lagjja Valias





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ

Hartë. Fshati Laknas






**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ**

Hartat sipas zonave në risk

Zona PaskuqanBregu i Lumit Tirana





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ**

Hartë. Pjesa Poshtë digës Liqenit Paskuqan





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ

Hartë. Zona Valias Rr. Nato afër lokal Vllezrit Lleshi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ

Hartë. Zona Frutikulturë Rr. Donald Tramp afër lokal Kolis





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ

Hartë. Zona risku në Bathore (lagjet 5; 6 dhe pjesërisht 7)





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ**

Organizimi dhe Menaxhimi i EC

Përballimi i emergjencës varet nga përfshirja dhe bashkërendimi i shumë institucioneve, strukturave të ndryshme dhe aktorëve të tjerë. Struktura zyrtare kryesore në bashki është KMC i kryesuar nga Kryetari i bashkisë i cili merr masat për menaxhimin dhe drejtimin e gjithanshëm të menaxhimit të emergjencave për bashkinë.

Menaxhimi i burimeve i referohet koordinimit, mbikëqyrjes dhe proceseve të kërkuara për të ofruar burime të përshtatshme në kohën e duhur. Në rast emergjence burimet janë të nevojshme në terren dhe tek mbështetja në terren për të mundësuar bashkinë të marrë masat e duhura. Procedura për të mundësuar sigurimin e burimeve të përshtatshme në kohën e duhur duhet të adresojnë sa vijon:

- Identifikimin e nevojave për burime.
- Menaxhimin e kërkesës për burime.
- Përcaktimin dhe menaxhimin e burimeve kritike.
- Dislokimin e burimeve.
- Demobilizimin e burimeve.
- Pagesat dhe rimbursimet.

Sasia e kapaciteteve të tjera shtesë që do të nevojiten do të varen nga shkalla e emergjencës. Bashkia do të duhet të bashkëpunojë ngushtë me Prefektin e qarkut për vlerësimin sipas rastit të nevojave për burime shtesë dhe sigurimin e tyre sa më shpejt që të jetë e mundur nga të gjitha subjektet shtetërore dhe joshetërore.

Duhet të planifikojmë tek situata sipas shkalles se demtimit edhe

Kerkim shpëtimi

Evakuimi

Strehim

Ofrimi i ndihmës së parë

Q. Shëndetësore

Rendi publik

Transporti dhe magazinimi

Paralajmrimi për situatën, njoftimet skema nga kryeplaku deri tek titullari , sistemimin sipas rasteve ne:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA KAMËZ

- Në objekte shtetërore
- Kampingje etj

Vlerësimi i Demëve

Praktikisht, është e pamundur të organizohen operacione të efektshme për përballimin e fatkeqësive, pa një vlerësim tepër të saktë të situatës së emergjencës dhe një vlerësimi të plotë të nevojave humanitare dhe nevojave të tjera.

Vlerësimi i dëmeve, si për rastet e shpalljes dhe mosshpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore, i referohet VKM Nr. 329, datë 16.5.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”.

Vlerësimi i dëmeve në objektet e banimit dhe infrastrukturë, për emergjencat civile vendore dhe rajonale, kryhet nga bashkia, ndërsa për emergjencat civile kombëtare nga Grupet Ndërinstitucionale të Vlerësimit.

Bashkia në bashkëpunim me Prefektin e qarkut do të punojë me ofruesit e shërbimeve komunale për të mbrojtur, për të menaxhuar dhe për të riparuar infrastrukturën publike gjatë emergjencave dhe fatkeqësive.

Strukturat kryesore të evidentuara në nivel bashkie me përgjegjësi në fushën e rehabilitimit të infrastrukturës publike dhe asaj kritike si edhe për punime rimëkëmbje të saj janë:

- Drejtoria e Emergjencave Civile dhe Strehimit.
- Drejtoria e Planifikimit të Territorit.
- Drejtoria e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve.
- Ndërmarrja e Shërbimeve Publike.
- Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor.
- Inspektorati Vendor i Mbrojtjes së Territorit.

Rimëkëmbja

Rimëkëmbja është rivendosja ose përmirësimi i mjeteve të jetesës dhe të shëndetit, aseteve ekonomike, fizike, shoqërore, kulturore dhe mjedisore,

Rimëkëmbja është faza e menaxhimit të emergjencës në të cilën implementohen/ndërmerren hapat dhe proceset për:

- Riparimin e komuniteteve të prekura nga një fatkeqësi;
- Rikthimin e kushteve në një nivel të pranueshëm ose, kur është e mundur, përmirësimi i tyre;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ

- Rivendosja e vetë-mjaftueshmërisë dhe rritja e aftësisë ripërtëritëse tek individët, familjet, organizatat dhe komunitetet.

Disa shembuj të masave të tilla janë.

- Strehimi i përkohshëm.
- Monitorimi i nevojave të kujdesit shëndetësor, përfshirë nevojat psikosociale, dhe ofrimi i vazhdueshëm i shërbimeve shëndetësore.
- Vlerësimi i ndikimit në mjedis.
- Rimëkëmbja ekonomike.
- Planifikimi dhe rindërtimi.

Emergjencat civile kategorizohen në:

- Emergjenca civile vendore, që vijnë si pasojë e fatkeqësive që ndodhin në një bashki dhe mund të përballohen me anë të veprimeve të strukturave kompetente të saj;
 - Emergjenca civile rajonale, që vijnë si pasojë e fatkeqësive që ndodhin në më shumë se një bashki që, për shkak të natyrës, shkallës dhe shtrirjes së tyre, kërkojnë ndërhyrjen e koordinuar të disa bashkive ose qarqeve;
 - Emergjenca civile kombëtare, që vijnë si pasojë e fatkeqësive që, për shkak të intensitetit, të shkallës dhe të shtrirjes së tyre, kërkojnë ndërhyrje të menjëhershme të të gjitha institucioneve të mbrojtjes civile, qendrore e vendore, edhe me masa të jashtëzakonshme, nëse është e nevojshme.
- t.

Dalja nga Emergjenca

I raporton Kryetarit të bashkisë dhe u komunikon të gjithë Kryetarëve të Nj.A në lidhje me etapën “Dalja nga situata”.

Informon të gjitha strukturat e varësisë, institucionet dhe strukturat monitoruese dhe njoftuese, operative vepruese dhe operative mbështetëse rreth etapës “Dalja nga Situata”.

Verifikon nëse informacioni dhe këshillat e duhura i janë transmetuar publikut nëpërmjet mjeteve të informimit publik..

Harton raportin përfundimtar të situatës dhe e dërgon tek Institucioni i Prefektit dhe nëse kërkohet edhe tek AKMC..

Mbledh të gjitha të dhënat duke i vendosur në dosjet përkatëse.

Siguron rikthimin e QOE në gjendjen e mëparshme dhe administratës së bashkisë në gjendjen normale.

Kthen pajisjet e marra hua nga strukturat e tjera Brenda ditës.

Kontrollon që mjetet e transportit që janë aktivizuar në situatë të kthehen në gjendje normale pranë institucioneve dhe firmave private.

Kërkon inventarin e gjendjes financiare dhe mbledhjen e faturave përkatëse.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ

Ndarja e zonave në një Emergjencë me Evakuim

Zonat e magazinimit të burimeve.

Janë vendet e mbledhjes së automjeteve, materialeve dhe personelit të nevojshëm për aktivitetet e shpëtimit.

Zonat e pritjes.

Janë vendet ku në momentet menjëherë pas fatkeqësisë, do të garantohet ndihma e parë dhe informacioni i parë për ngjarjen për popullatën, në pritje të përgatitjes së vendeve të strehimit ose kthimit në kushte normale të jetesës.

Zonat e strehimit.

Zonat e strehimit janë vende dhe hapësira që mund të strehojnë ambiente akomodimi për të garantuar ndihmë dhe rikuperim për ata që duhet të lënë shtëpitë e tyre. Identifikimi i tyre duhet

të bëhet nga bashkia, e mbështetur nga Prefekti i qarkut dhe nëse është e mundur edhe AKMC.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ
SKENAR PËRMBYTJE NË NJËSINË ADMINISTRATIVE PASKUQAN

Rasti përmbytje

Territori i Njesisë Administrative Paskuqan, në disa zona është i ekspozuar dhe ka një rrisht nga përmbytjet, të cilat shkaktohen nga lumi i Tiranës, në rastin e reshjeve të dendura të shiut dhe prurjeve të mëdha duke shkaktuar daljen e tij nga shtrati e për pasojë duke shkaktuar përmbytje në banesat dhe bizneset të cilat ndodhen në afërsi të shtratit të lumit.

Nga vlerësimet e kryera të përmbytjeve të mëparshme rezulton se lumi i Tiranës përbën rrezik të përmbytjeve që shkaktohen në territorin e Njesisë Administrative Paskuqan.

Theksojmë se, si rezultat i rehabilitimit të lumit nga Bashkia Tiranë kanë rënë ndjeshëm dëmet e shkaktuara nga përmbytjet në territorin e Njesisë Administrative Paskuqan.

Njëkohësisht në lagjen Paskuqan 2 Fushë, zonë e cila është prekur nga përmbytjet si rezultat i dëmtimit të shkarkuesit të kolektorit kryesor të digës rezervuarit të Paskuqanit, është eliminuar si rezultat i rehabilitimit të plotë të digës dhe kolektorit të rezervuarit, investim ky i realizuar nga Bashkia Kamëz.

SISTEMI I NJOFTIMIT NË NJË RAST RREZIKU TË PËRMBYTJES

Për përballimin e përmbytjeve në rastin e reshjeve të dendura dhe situatave tjera emergjente, në Njesisë Administrative Paskuqan, mbështetur në ligjin për emergjencat civile, dhe urdhërin e Kryetarit të Bashkisë “Për ngritjen e shtabit të emergjencave, dhe përballimin e situatave emergjente”, në Njesisë Administrative Paskuqan është ngritur shtabi i emergjencave, i cili kryesohet nga Administratori i Njesisë, me përbërje si më poshtë:

Nr	Personi përgjegjës	Funksioni	Nr. Tel	Pozicioni i punës	E-mail
1	Perparim Oka	Kryetar	0685693083	Administrator	adm.paskuqan@kamza.gov.al
2	Sokol Allaraj	Anëtar	0684638170	Përgj.Nd.Ek.	sokol.allaraj@kamza.gov.al
3	Astrit Vata	Anëtar	0682267604	Specialist	astritvata1@gmail.com
4	Xhemal Doda	Anëtar	0686479805	Specialist	xhemaldoda@yahoo.com
5	Elsen Haxhillari	Anëtar	0695471851	Specialist	elsenhaxhillari@gmail.com
6	Xhaferr Sefa	Anëtar	0682390136	Specialist	
7	Kol Hila	Anëtar	0682703837	Specialist	



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ

Njëkohësisht pjesë e grupit të punës në shtabin e emergjencave të Njesisë janë punonjësit e Bashkisë, dhe anëtarët e Këshillit Bashkiak të cilët janë banorë të Njesisë Administrative Paskuqan.

Duke qenë se territori i Njesisë Administrative Paskuqan përshkohet nga lumi i Tiranës, nga kafja e Rremës deri në afërsi të urës Institutit, i cili shërben dhe kufi ndarës me Bashkinë Tiranë, si rezultat i reshjeve të dendura dhe prurjeve të shumta, lumi del nga shtrati duke shkaktuar përmbytje të një numri banesash të familjeve dhe bizneseve të vogla të cilat ndodhen në afërsi të shtratit të lumit.

Zonat më të rrezikuara të cilat preken nga përmbytjet e këtij lumi janë:

- Babrru Shpat me numrin më të madh të banesave në afërsi të shtratit të lumit
- Babrru Qendër
- Paskuqan 1
- Paskuqan 2 Fushë.

FAZAT PËR PËRBALLIMIN E SITUATAVE EMERGJENTE.

Fazat për përballimin e situatave emergjente në territorin e Njesisë Administrative Paskuqan, në rast përmbytje dhe situata të tjera janë si më poshtë:

1. ALARMI
2. GATISHËMRIA
3. AKTIVIZIMI
4. DALJA NGA SITUATA

ALARMI: Funkzionon nga poshtë lart ose nga lart poshtë.

Në rastin e parë nga poshtë lart funksionon në mënyrë të tillë ku Kryetari i Fshatit ose banor të zonës së përmbytur njoftojnë Administratorin e Njesisë, dhe ky i fundit njofton menjëherë anëtarët e shtabit të emergjencave të ngritur në Njësi duke i vënë në dijeni për situatën që mund të krijohet nga përmbytjet. Gjithashtu Administratori njoftin edhe eprorin kryetarin e Bashkisë.

Në rastin e dytë nga lart poshtë funksionon në mënyrë të tillë ku Administratori i Njesisë si Kryetar i shtabit të emergjencave civile në Njësi, njofton menjëherë Kryetarët e Fshatrave në zonat e prekura, dhe anëtarët e shtabit të emergjencave civile të Njesisë Administrative duke i vënë në dijeni për situatën që mund të krijohet nga përmbytjet.

Administratori që është njëkohësisht dhe Kryetar i shtabit të emergjencave në Njësinë Administrative njofton Kryetarin e Bashkisë duke e vënë në dijeni për situatën që mund të krijohet nga përmbytjet.

GATISHËMRIA: Menjëherë sapo njoftohen të gjithë anëtarët e shtabit të emergjencave civile në Njësinë Administrative mblidhen dhe informohet grupi për situatën emergjente që po afron,



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ

zonat që preken, dhe ndahen detyrat për përballimin e situatës. Njoftohen gjithashtu strukturat tjera për të qenë në gatishmëri për përballimin e situatës dhe konkretisht:

Punonjësit e Shëndetësisë për mbajtjen nën kontroll të banorëve të cilët paraqesin probleme shëndetësore si rezultat i përmbytjeve.

Punonjësit e OSHE për mbajtjen nën kontroll të situatës energjitike në zonën e rrezikuar nga përmbytja.

Punonjësit e Policisë Shtetit për mbajtjen nën kontroll dhe stabilizimin e situatës si rezultat i panikut të krijuar.

Njoftohen OJF, dhe Biznese të cilët operojnë në territorin e Njësisë për të qenë të gatshëm, për të dhënë kontributin e tyre me ushqime, dhe rroba fjetje e veshmbathje në ndihëm të familjeve që mund të preken nga përmbytjet.

Njëkohësisht merren masa të menjëherëshme për sigurimin e vendstrehimit për banorët që kanë nevojë për evakuim.

DALJA NGA SITUATA: Menjëherë sapo situata ka ndodhur grupi i punës ose shtabi i emergjencave civile të Njësisë Administrative vazhdon punën në terren sipas detyrave të pëcaktuara më parë nga Kryetari i shtabit për:

- Evidentimin e zonave dhe familjeve të prekura nga përmbytja.
- Njoftimin e punonjësve të OSHE për ndërprerje të energjisë elektrike në zonat e prekura nga përmbytjet.
- Evakuimin e menjëhershëm të banorëve apo familjeve që kanë nevojë emergjente për evakuim.
- Evidentimin e plotë të dëmeve të shkaktuara nga përmbytja në territorin e Njësisë Administrative Paskuqan, në banesa, orendi shtëpiake, biznese, infrastrukturë, etj, duke i reflektuar të gjitha në një raport të sakt.

SI NDODHI PËRMBYTJA

Shkaku kryesor i përmbytjes ishte sasia e madhe e reshjeve të dendura të shiut rreth 90 mm, e cila vazhdoi me ndërprerje për rreth 72 orë. Kjo shkaktoi prurje të mëdha uji e cila tejkalon kapacitetin përcjellës të lumit, duke shkaktuar daljen e tij nga shtrati dhe dëmtimin e shumë banesave, bizneseve dhe infrastrukturës.

Si rezultat i lëvizjes demografike të popullësisë shumë banorë kanë bërë ndërtime të reja në afërsi të shtratit të lumit deri në krijimin e fshatrave të rinj që janë zona më rrisk të lartë përmbytje, kjo dhe për arsye të kostos së ulët të truallit dhe pronësisë në këtë pjesë të territorit të Njësisë.

NDIKIMI MBI NJERËZIT DHE PASURITË E TYRE

Popullësia e prekur direkt nga përmbytjet është 171 banorë, e ndarë si më poshtë:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ

- Lagjja Babrru Shpat 122 banorë
- Lagjja babrru Qendër 27 banorë
- Lagjja Paskuqan 9 banorë
- Lagjja Paskuqan 2 Fushë 13 banorë

Nga ndjekja dhe vlerësimi i situatës në terren rezultoj:

- Kanë nevojë për asistencë mjeksore gjithësej 23 banorë.
- Kanë nevojë për evakuim të menjëhershëm 138 banorë.
- Janë dëmtuar gjithësej 39 banesa (thellësia e ujit 200 mm), duke pësuar dëmtime në dyer, suva, lysterje, orendi shtëpiake etj. Ora në të cilën ndodhi përmbytja dhe shpejtësia e rritjes së nivelit të ujit nuk u la kohë të gjithë banorëve të zhvendosnin mobiljet dhe orenditë tjera shtëpiake nga banesa në katet e mësipërme apo diku tjetër.
- Janë dëmtuar 1 biznes privat që kanë pësuar dëme ndërtimore, dëme në mobilje, paisje dhe dëme në mallrat që tregëtojnë.
- Janë 11 banesa me prani uji vetëm në oborret e tyre.

Ndikimi në infrastrukturë dhe mjedisin në tërësi.

- Është dëmtuar infrastruktura rrugore në disa segmente, dhe janë bllokuar disa nga kolektorët e shkarkimit dhe kanalizimet e ujrave të bardha dhe të zeza.
- Qarkullimi rrugor në territorin e Njesisë Administrative Paskuqan është kryer me vështirësi gjatë gjithë kohës së reshjeve të dendura për shkak të nivelit të lartë të ujrave.

NEVOJAT E POPULLËSISË PËR PËRGJIGJE, BURIMET QË DISPONOHEN DHE ATO QË NEVOJITEN, TRAJTIMI I PROBLEMATIKAVE.

Paralajmërimi i hershëm dhe informimi i publikut për emergjencën, këshillimi i publikut, u desh të kryhej gjatë gjithë periudhës së emergjencës.

Kërkim shpëtimi: Nevojitej në 2 banesa ndërhyrja si dhe 1 familje të bllokuara në atomjete në parking.

Evakuimi: U evakuan 39 familje gjithësej.

Strehimi: Pas marrjes masave për situatën emergjente u përgatitën ambjentet e palestrës së gjimnazit “Gramoz Palushi” me qëllim strehimin e 35 familjeve të dëmtuara. 4 (katër) familje janë strehuar tek të afërmit e tyre.

Sigurimi i furnizimit me ndihëm ushqimore, veshmbathje dhe artikuj të tjerë të jetës: Për 35 familjet e strehuara përkohësisht në ambjentet e palestrës së shkollës “Gramoz Palushi” nga OJF-t, bizneset e zonës në territorin e Njesisë Administrative Paskuqan.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA KAMËZ

Do të merrej në konsideratë dhe furnizimi me artikujt e emergjencës dhe për 4 familje të strehuara tek të afërmit e tyre.

Nevojat shëndetësore: Nevojitej shtrim në spital për 3 persona të lënduar, si dhe kishin nevojë për asistencë mjeksore 11 banorë.

MASAT PËR REHABILITIMIN E INFRASTRUKTURËS

- Pastrimi urgjent i rrugëve në zonat e dëmtuara.
- Pastrimi dhe vënja në funksion të plotë e të gjithë rrjetit të kanalizimeve.
- Rregullimi i të gjitha avarive të linjave elektrike të dëmtuara.
- Pastrimi i menjëhershëm i kolektorëve të shkarkimit.
- Kontrolli dhe disiplinimi i trafikut në të gjitha segmentet rrugore.
- Masat e ruajtjes dhe të sigurisë për ndërtesat familjet e të cilave janë evakuar, zbatimi i ligjit dhe masat për ruajtjen e rendit publik.
- Analizat e vazhdueshme të ujit pishëm dhe në rastet e evidentimit të ujrave të ndotura, sigurimi i furnizimit të banorëve me ujë të pastër.
- Nevoja për mbajtjen nën kontroll të shëndetit publik, sigurimin e shërbimeve të ndihmës sociale, mbështetjen psiko-sociale dhe zvoglimin e panikut të krijuar tek banorët e prekur nga përmbytja.

SI E NDOQI SITUATËN EMERGJENTE SECILI INSTITUCION

Shëndetësia: Menjëherë pas marrjes njoftimit për situatën e krijuar u vendos në dispozicion të shërbimit shëndetësor për të gjithë personat e lënduar, si dhe ata të cilët kishin nevojë për asistencë mjeksore.

Policia: Punonjësit e Policisë janë vënë menjëherë në shërbim të ruajtjes së rendit dhe qetësisë publike, menaxhimin e levizjes së automjeteve për shkak të përmbytjes në zonat e prekura.

Elektriku: Punonjësit e OSHE-s realizuan në një kohë të shpejt ndërprerjen e energjisë elektrike në zonat e përmbytura me qëllim eliminimin e pasojave fatale për jetën që mund të shkaktoj energjia elektrike nga përmbytja tek banorët.

Arsimi: Pas njoftimit të ZAK për situatën e krijuar nga përmbytjet nga Drejtoria e shkollës “Gramoz Palushi” me qendër në Babrru na është vënë në dispozicion palestra e shkollës, ambjent i cili u shfrytëzua për akomodimin e banorëve të evakuar nga përmbytjet.

INSTITUCIONET SHTETËRORE, OJF DHE BIZNESET: Pas njoftimit të Prefekturës Qarkut Tiranë, për situatën e krijuar në zonat e prekura nga përmbytjet në territorin e Njësisë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ

Administrative Paskuqan menjëherë u morën masat për paisjet me rroba fjetje, veshmbathje dhe ushqime tjera të nevojshme për akomodimin e personave të evakuar në palestrën e shkollës “Gramoz Palushi” nga Rezervat e Shtetit, njëkohësisht kanë dhënë kontributin e tyre me ndihma ushqimore dhe veshmbathje dhe shoqata e CARITAS-it dhe mjaft biznese të cilat operojnë në territorin e Njesisë Administrative Paskuqan, kryesisht ato biznese që ndodhen në afërsi të zonave të prekura nga përmbytjet.

HISTORIKU I PERMBYTJEVE DHE TERMETIT, DJEGIJET

PËRMBYTJET

Përmbytje në vitin 2013

Në mënyrë të përmbledhur, nga situata e përmbytjeve e krijuar nga reshjet e shiut në vitin 2013 evidentohet banesat e përmbytura sipas zonave nëpërmjet tabelës së mëposhtme:

Nr	Emërtimi i zonës	Banesa të përmbytura
1	Frutikulturë	11
2	Bathore	108
3	Valias	75
4	Zal-Mner	69
5	Laknas	11
TOTALI		274

Përmbytje në vitin 2015

Në mënyrë të përmbledhur nga situata e përmbytjeve e krijuar nga reshjet e shiut në vitin 2015 evidentohet:

Nr	Emërtimi i zonës	Banesa të përmbytura
1	Paskuqan	78
2	Bathore	53
3	Valias	38
4	Laknas	62
5	Frutikulturë	55
TOTALI		286



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ

Përmbajtje në vitin 2016

Në mënyrë të përmblledhur nga situata e përmbajtjeve e krijuar nga reshjet e shiut më dt. 08.11. 2016 evidentohet: (VKB nr. 131, dt. 23.11.2016. Vlera 88.588.000 lekë)

Nr	Emërtimi i zonës	Banesa të përmbajtura
1	Paskuqan	89
2	Bathore	161
3	Kamëz	54
4	Laknas	68
5	Frutikulturë	37
6	Zall-Mner	30
TOTALI		420

Përmbajtje në vitin 2017

Në mënyrë të përmblledhur nga situata e përmbajtjeve e krijuar nga reshjet me 30.11. 2017 evidentohet: (VKB nr. 137, dt. 11.12.2017. Vlera 276.051.865 lekë)

Nr	Emërtimi i zonës	Banesa të përmbajtura
1	Paskuqan	21
2	Bathore	152
3	Kamëz	71
4	Valias	269
5	Frutikulturë	145
6	Laknas	40
TOTALI		698

Përmbajtje në vitin 2019

Në mënyrë të përmblledhur nga situata e përmbajtjeve e krijuar nga reshjet e shiut më datë 23.09.2019 evidentohet: (VKB nuk ka, Vlera e dëmit 155.772.124 lekë, kjo afersisht me llogaritje)

Nr	Emërtimi i zonës	Banesa të përmbajtura
1	Paskuqan	55
2	Bathore	62
3	Kamëz	162



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ

4	Valias	50
5	Frutikulturë	51
6	Laknas	15
TOTALI		395

Familjet e përmbytura sipas viteve

Nr	Viti	Numeri familjeve përmbytura
1	2013	274
2	2015	287
3	2016	420
4	2017	697
5	2019	395
6	2023	4
7	2024	1
		2078

TËRMETET

Territori i Bashkisë Kamëz është i rrezikuar nga fatkeqësitë natyrore madhore si tërmetet dhe për shkak të lëvizjes demografike të popullsisë në mënyrë të pa organizuar edhe nga përmbytjet .

Tërmetet e fuqishme të vitit 2019 për nga pasojat, lanë më shumë gjurmë në historinë e ngjarjeve të fatkeqësive natyrore të ndodhura.

Ky territor bën pjesë në zonën sizmoaktive.

Tërmetet i dates 21.09.2019.

Ky tërmet shkaktoi dëmtime edhe në bashkinë tonë. Si pasojë e këtij tërmeti pati dëmtime në objektet e banimit me dëmtime në rifiniturë dhe për një pjesë edhe dëmtime në strukturën e objektit. Për fatin e kësaj zone nuk pati dëmtime në njerëz.

Nga tërmeti i kësaj date u dëmtuan 395 objekte.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ

Tërmetet i dates 26.11.2019.

Nga ky tërmet Bashkisë Kamëz ju shkaktuan dëmtime në një shkallë të konsiderueshme. Nuk pati dëmtime në njerëz ; por ky qe më i fuqishëm se tërmeti i dy muajve të mëparshëm dhe për pasojë pati më shume dëmtime. Si pasojë e këtij tërmeti kishim dëmtime të pronës banesave me prishje të strukturës ku shumë banesa u vlersuan si të pa banueshme.
Nga tërmeti i kësaj date u dëmtuan 2184 objekte.


DATABASE PER TERMETIN E DATES 26.11.2019

Nr	Kategoria	Nj.Ad. Paskuqan	Lgj. Bathore	Kamez	Bashkia (totali)
1	DS 1	187	128	279	594
2	DS 2	344	231	321	896
3	DS 3	114	184	131	429
4	DS 4	101	118	253	472
5	DS 5	59	46	194	299
6	Rikonstruksin				24
	shuma	805	707	1178	2714



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ

Nr. familjeve



Në tabelën e mëposhtme po paraqesim numërin e familjeve sipas kategorisë së vlerësimit dhe vlerat financiare të dëmit.

Nr	Kategoria Vlerësimit	Bashkia Nr. Familjeve	Vlera lekë	vlera mesatare e një banese për ndërtim
1	DS 1	594	90,000,000	Rikonstruksion
2	DS 2	896	230,000,000	Rikonstruksion
3	DS 3	429	450,000,000	Rikonstruksion
4	DS 4	472	1,463,200,000	3,100,000
5	DS 5	299	926,900,000	3,100,000
	shuma tërmeti 26.11.2019	2690	3,160,100,000	
6	Tërmeti	202		




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ

	21.09.2019		84,451,678	3,100,000
7	R1 Akmc 24 ndërtesa	24	74,400,000	3,100,000
	shuma e dëmit	2916	3,318,951,678	

Me anë të grafikut të mëposhtëm po ilustrojmë krahasimin e dy tërmeteve sipas vlerës financiare.

Chart Title





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ

ZJARRET

Pothuajse çdo vit, në periudhën e nxehtë të verës ndodhin zjarre që përfshijnë banesa të ndryshme.

. Temperaturat e larta, mungesa e reshjeve dhe thatësira e tejzgjatur, karakteristika këto për periudhën e verës, të cilat kanë bërë që të kemi edhe zjarre në banesa.

Territori i Bashkisë Kamëz është një zonë informale, në ndërtim e sipër , me probleme të mëdha sociale . Infrastruktura e zonës është përshtatur me vështërsi. Probleme me instalimet elektrike në banesa, rrjeti elektrik i papershtatshëm etj.


Prandaj edhe për këtë problem dhe të tjerat të sipercituara del si kërkesë përgatitja e një plani strategjik për të minimizuar rrisqet në këtë drejtim. Ndër vite është ndërhyrë dhe janë menaxhuar nga Bashkia për **banesat e djegura**.

Nr	VITI	Lloji fatkeqsise		Vlera totale	
		Zjarre	Të tjera, +	Vlerat leke	
	Viti 2012 nr. familje	1	0	1,122,353	
	Viti 2013	0	0	-	
	Viti 2014	4	0	1,089,509	
	Viti 2015	4	0	4,112,097	
	Viti 2016	3	0	4,367,623	
	Viti 2017	10	0	11,325,344	
	Viti 2018	15	0	16,478,916	
	Viti 2019	1	0	1,306,308	
	Viti 2020	5	0	7,275,695	
	Viti 2021	5	0	2,363,783	
	Viti 2022 1 + 2	7	6	6,125,026	
	Viti 2023 1 + 2	11	1	8,531,083	
	Viti 2024 1 + 2	9	4	6,877,527	
				70,975,264	
	te tjera pa pages 2024	75	11	28,785,568	
				99,760,832	dëmi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ

Chart Title





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ**

KU DUHET TË FOKUSOHET BASHKIA (KMC.B) ?

Duhet të fokusohemi në:

- Zbutja e riskut të fatkeqësive.
- Ngritja e kapaciteteve për vlerësimin e riskut të fatkeqësive.
- Hartimi i Strategjisë për ZRF.

Bazuar në materialin e paraqitur më lart Bashkia Kamëz duhet të jetë e përgatitura si nga ana e kapaciteteve njerëzore, financiare e teknike ashtu dhe nga pikëpamja e instrumentave të cilët përdoren për të qeverisur territorin. Prandaj kemi hartuar këtë plan emergjencash civile. Ky dokument vendos një theks të madh të veprimeve tek përgjigjia pas krizave. Nga ana tjetër, nismat për parapërgatitjen ndaj krizave ishin të pakta dhe jo të mjaftueshme. Pra vetë logjika e dokumentit, bazuar në traditën institucionale të përgjigjes ndaj krizave në Shqipëri, shtyn më shumë drejt përgjigjes pas krizës, sesa drejt reduktimit të riskut. Ky është një ndër dokumentet që do të rishikohet e plotësohet në zhvillimin e mëtejshëm të projektit.

Planifikimi i territorit, shihet si një instrument shumë i vlefshëm dhe komplementar me strategjinë e reduktimit të riskut për të rritur aftësinë ripërtëritëse të komuniteteve.

Pas kryerjes së vizitave në terren dhe intervistave me komunitetin, dhe një sërë takimesh me drejtorite e institucioneve që veprojnë në zonë në nivel qarku dhe drejtorive në bashki u bë i mundur hartimi i këtij plani për të kryer hartëzimin e riskut.

Përsa i përket zbutjes, menaxhimit dhe parandalimit të rreziqeve në Bashkinë Kamëz duhet të kemi parasyshë funksionimin si më poshtë:

1. Sistem monitorimi të sejcilit rrezik.
2. Sistem paralajmërimi .
3. Kontroll periodike të rrisqeve.
4. Rakordimi me të gjithë aktorët në nivel qendror dhe lokal.
5. Miradministrimi i situatave të rrisqeve të mundëshme.
6. Regjistrimi i detajuar i ngjarjeve. Trajnimi i popullsisë dhe edukimi i brezave të rinj në shkolla si duhet të veprojmë në raste rreziqesh.
7. Bashkia të trajtojë me prioritet dhe të krey vlerësimet dhe studimet për sejcilin rrisk.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ

8. Përgatitja e planeve të gatishmërisë dhe emergjencave për të gjitha rastet me rrezik në territorin e Bashkisë Kamëz.

Objektivi kryesor i menaxhimit të rrezikut

1. Shëndeti I njeriut
2. Mjedisi
3. Trashëgimia kulturore.
4. Aktiviteti ekonomik

Përgj/ Emergjencave Civile.

Shkëlzen KORBI

Dr.Emergjencave Civile dhe Strehimit

Teuta CAMI